

Marrëveshja AIDA dhe ABSL Albania për Zhvillimin e Biznesit në Shqipëri

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), e përfaqësuar nga Drejtoresha Ekzekutive znj. Laura Saro, dhe Association of Business Service Leaders (ABSL Albania), e përfaqësuar nga Presidentja znj. Arjodita Mustali, nënshkruan një Memorandum Mirëkuptimi.

- Përmirësimin e klimës së biznesit në Shqipëri;
- Organizimin e aktiviteteve edukuese dhe tryezave të përbashkëta për sfidat dhe mundësitë në sektor;
- Promovimin e bashkëpunimit mes aktorëve lokalë dhe ndërkombëtarë;
- Ndërgjegjësimin mbi potencialin e sektorit të shërbimeve të biznesit.

Nëpërmjet kësaj marrëveshjeje, AIDA dhe ABSL Albania angazhohen për të mbështetur zhvillimin e sektorëve strategjikë si BPO, ITO, SSC dhe R&D, duke krijuar ura bashkëpunimi dhe promovuar Shqipërinë si një destinacion tërheqës për investime.



AIDA priti në takim Ambasadorin e Republikës së Kazakistanit

Drejtoresha Ekzekutive e AIDA, znj. Laura Saro, priti në takim Ambasadorin e Republikës së Kazakistanit në Shqipëri, z. Iskander Aisariyev.

Gjatë takimit, u diskutua mbi mundësitë për forcimin e marrëdhënieve ekonomike dhe bashkëpunimit dypalësh, me fokus të veçantë në nxitjen e investimeve dhe promovimin e sektorëve me potencial të lartë.

Ky takim shënon një hap të rëndësishëm drejt konsolidimit të partneritetit ndërmjet Shqipërisë dhe Kazakistanit.





AIDA priti në takim Ambasadoren e Algjerisë në Shqipëri

Drejtoresha Ekzekutive e AIDA, znj. Laura Saro, priti në takim Sh.S.Znj. Zaina Benhabouche, Ambasadore e Algjerisë në Shqipëri. Gjatë takimit u diskutua nënshkrimi i një Memorandumi Mirëkuptimi (MoU) mes AIDA-s dhe homologut algjerian, si dhe forcimi i bashkëpunimit ekonomik mes dy vendeve. Vëmendje e veçantë iu kushtua përforcimit të marrëdhënieve tregtare dhe veçanërisht në sektorin e bujqësisë, duke identifikuar potencialin e madh për shkëmbime dhe projekte të përbashkëta. Ky bashkëpunim synon të nxisë zhvillimin ekonomik dhe të forcojë lidhjet mes Shqipërisë dhe Algjerisë.

Ftesë për pjesëmarrje

“Panairi Food Ingredients” - North America, Supply Side West US

Food Ingredients - North America është cilësuar si një nga panairët më të mëdhenj të ushqimit organik, dhe bimëve aromatike dhe medicinale, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), në bashkëpunim me ITC Albania (Internacional Trade Centre) dhe SIPPO Albania (Swiss Import Promotion Programme) po planifikojnë pjesëmarrjen me stendë të Shqipërisë në këtë panair, i cili do të zhvillohet në Las Vegas, USA, në datat 27-30 Tetor 2025. AIDA, fton të gjitha kompanitë që kanë interes për të marrë pjesë në panair dhe që plotësojnë kriteret e mësipërme, të plotësojnë formularin e profilit të kompanisë që gjeni në linkun <https://lnkd.in/eAD5NwHT> dhe ta dërgojnë në adresën e emailit: info@aida.gov.al brenda datës 31 janar 2025.

“Forumi Kulinar GastromoniX 2025”, në datat 18-22 shkurt 2025, Sofje, Bullgari

Ftesë për pjesëmarrje në “Forumit Kulinar GastromoniX 2025”, në datat 18-22 shkurt 2025, Sofje, Bullgari Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), ju informon se në datat 18-22 shkurt 2025 Shoqata Bullgare e Kuzhinierëve Profesionistë dhe Qendra Inter Expo do të zhvillojë Forumin Kulinar GastromoniX 2025 – “Shumëllojshmëria e kuzhinës mesdhetare”. Për vitin 2025 GastromoniX fton vendet e rajonit të Mesdheut të prezantojnë traditat e tyre të kuzhinës unike. Pritet pjesëmarrja e mbi 16,000 profesionistëve nga sektorët e kulinarisë, restoranteve, hotelerisë dhe shitjes me pakicë të ushqimit.

Edicioni i 4-ët i “FoodTech” dhe Edicioni i 2-të i “Global Pack”, në datat 07-10 nëntor 2025, Athinë, Greqi

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), ju informon se në datat 07-10 nëntor 2025, “FORUM SA” organizon “Edicionin e 4-ët të “FoodTech” dhe Edicionin e 2-të të “Global Pack”, në Metropolitan Expo, Athinë. Edicioni 2023 FOODTECH & Global Pack numëroi 280 ekspozues dhe 15,180 vizitorë tregtarë nga të cilët 560 vizitorë ndërkombëtarë morën pjesë në më shumë se 3000 takime B2B. Kjo është një mundësi shumë e mirë për biznese, kompani dhe sipërmarrës nga Shqipëria që të jenë pjesë e kësaj eksperience dhe të eksplorojnë mundësitë e biznesit që rajoni i gjerë mund të ofrojë në sektorët e lartpërmendur.



AIDA gati për Panairot ndërkombëtare Janar-Mars 2025

AIDA gati për Panairot ndërkombëtare gjatë tre mujorit të parë të vitit, me stande kombëtare të Shqipërisë, për të promovuar vendin si destinacion investimi dhe për të mbështetur bizneset shqiptare drejt ndërkombëtarizimit. Njihuni me datat e panairove ku Shqipëria do jetë pjesë gjatë periudhës Janar-Mars 2025.



Vizita në ambientet e bizneseve pjesëmarrjese të panairit ndërkombëtar "BIOFACH 2025"

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), në bashkëpunim me SIPPO Albania dhe ITC Albania (Projekti Intracen), në kuadër të organizimit dhe pjesëmarrjes me stande në panairin ndërkombëtar "BIOFACH 2025", organizoi gjatë datave 14-16 janar 2025, vizita në ambientet e 6 (gjashtë) bizneseve të cilat do të jenë pjesëmarrëse në këtë panair. Pjesë e këtyre takimeve ishin dhe 2 ekspertë të SIPPO Albania, z. Roland Bagaviki dhe z. Gustavo Ferro.

Qëllimi i këtyre vizitave shërbeu për t'u njohur me produktet e këtyre kompanive, proceset e tyre të punës, duke filluar nga prodhimi e deri në finalizimin e produktit final, tregjet e huaja, shërbimet e marketingut, pritshmëritë e tyre, organizimin e takimeve B2B, me qëllim hartimin e një plani strategjie për pjesëmarrjen në panair.

-Gjithashtu, në ambientet e AIDA-s, u zhvillua në mënyrë hibride workshopi me temë "Informacion mbi tregjet e huaja" nga eksperti, z. Gustavo Ferro, i cili prezantoi gjithashtu dhe një plan pune mbi strategjinë që do ndiqet deri në zhvillimin e panairit.



AIDA organizon një mini-panair me produkte nga Shqipëria dhe Mali i Zi

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), në kuadër të zbatimit të projektit "Aftësi për Punësim të Qëndrueshëm dhe Rritje Ekonomike Gjithëpërfshirëse të Rajonit Ndërkufitar të Shqipërisë dhe Malit të Zi - Aftësi për Punësim Shqipëri - Mal i Zi", "Programi i Bashkëpunimit Ndërkufitar Mal i Zi - Shqipëri 2014 - 2020", nën Instrumentin Për Asistencën e Para-Aderimit (IPA II), financuar nga Bashkimi Evropian, në bashkëpunim me Dhomën Ekonomike në Mal të Zi dhe Fondacionin Business Start Center Bar, organizoi në datën 21 janar 2025, pranë qendrës "Arka Youth Center" një mini-panair në qytetin e Shkodrës me produkte nga Shqipëria dhe Mali i Zi.

Në këtë event morrën pjesë 9 kompani shqiptare dhe 15 kompani të Malit të Zi, të sektorit të artizanatit, turizimit dhe teknologjisë së informacionit me qëllim promovimin e produkteve të tyre, organizimin e takimeve B2B me partnerë potencialë që operojnë në të njëjtët sektorë.



AIDA-BIOFACH 2025 Kompanitë pjesëmarrëse

Për herë të katërt në BIOFACH 2025 Shqipëria do të jetë në qendër të vëmendjes për produktet organike në këtë panair prestigjioz, në datat 11-14 Shkurt 2025 Hall 5, Stand 171 | Nuremberg Messe, Gjermani. 8 kompani të shkëlqyera shqiptare do të jenë në pavijonin tonë:

1. Musai Olive Oil – Vaj ulliri premium
2. Olivae Oleoteca – Vaj ulliri organik ekstra i virgjër
3. Essential – Vajra esenciale natyrale
4. Natural Herbal E.V.R. – Bimë medicinale dhe aromatike
5. BioBes – Bimë medicinale dhe aromatike
6. Ekoprod – Bimë medicinale dhe aromatike
7. Albanian Herb – Bimë organike me vlera të larta ushqyese
8. Vasilis Organic – Bimë organike

Vizitoni pavijonin shqiptar dhe zbuloni produktet tona organike, që pasqyrojnë pasurinë natyrore dhe traditën e përkushtimit!

BIOFACH
AIDA-Biofach 2025!

Për herë të katërt që prej vitit 2020

- 35,000 vizitorë
- 130 vende
- 2,500 ekspozues

11-14 Shkurt 2025
Hall 5, Stand 171,
Nuremberg Messe,
Gjermani

www.aida.gov.al

Shqipëria në BIOFACH 2025 – Një Traditë Suksesi në Promovimin e Produkteve Organike

Pas sukseseve të viteve të kaluara, ne vazhdojmë të prezantojmë potencialin tonë të jashtëzakonshëm përballë mbi 35,000 vizitorëve nga më shumë se 130 vende dhe mbi 2,500 ekspozuesve nga e gjithë bota.

Pjesëmarrja shqiptare këtë vit, në këtë event prestigjioz organizohet nga AIDA (Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve), në bashkëpunim me ITC (International Trade Centre) dhe programin SIPPO Albania, duke ofruar një platformë të rëndësishme për promovimin e produkteve shqiptare në tregjet ndërkombëtare.

Panairi “Wine Paris”, i cili do të mbahet në datat 10-12 shkurt 2025

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) ka kënaqësinë t’ju ftojë të merrni pjesë në panairin “Wine Paris”, i cili do të mbahet në datat 10-12 shkurt 2025, në Paris Expo Porte de Versailles, Francë.

Për herë të parë, Shqipëria do të jetë pjesëmarrëse me stand të dedikuar në këtë panair, i cili është ndër aktivitetet më të mëdha ndërkombëtare për industrinë e verërave dhe pijeve alkoolike.

“Wine Paris” është një pikëtakim për tendencat, konceptet dhe idetë më të reja e inovative në fushën e verës, të cilat do të formësojnë suksesin e ardhshëm të kësaj industrie.



Për herë të parë, tradita mbi 2000-vjeçare e verës shqiptare në “Wine Paris 2025”!

Historia e verës shqiptare, që daton mbi 2000 vjet më parë, nis me ilirët, të cilët kultivonin rrush dhe prodhonin verë, duke krijuar themelet e një tradite të pasur dhe të qëndrueshme. Përmes epokave të Perandorisë Romake, Bizantine, dhe sfidave të modernitetit, kjo trashëgimi ka mbijetuar dhe është zhvilluar, duke u kthyer në një identitet kombëtar krenarie.

Në “Wine Paris 2025”, Shqipëria do të shpalojë për herë të parë këtë traditë të lashtë në një nga skenat më të mëdha ndërkombëtare për industrinë e verës. Vera shqiptare drejt njohjes globale dhe krijimit të mundësive të reja për eksport dhe bashkëpunim tregtar.

Konferenca përmblyëse në kuadër të zbatimit të projektit “Aftësi për Punësim të Qendrushëm dhe Rritje Ekonomike”

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), në kuadër të zbatimit të projektit “Aftësi për Punësim të Qendrushëm dhe Rritje Ekonomike Gjithëpërfshirëse të Rajonit Ndërkufitar të Shqipërisë dhe Malit të Zi – Aftësi për Punësim Shqipëri – Mal i Zi”, “Programi i Bashkëpunimit Ndërkufitar Mal i Zi – Shqipëri 2014 – 2020”, nën Instrumentin Për Asistencën e Para-Aderimit (IPA II), financuar nga Bashkimi Evropian, në bashkëpunim me Dhomën Ekonomike në Mal të Zi dhe Fondacionin Business Start Up Center Bar, organizoi konferencën përmblyëse të projektit në qytetin e Shkodrës, më datë 22 janar 2025.

Pjesë e konferencës ishin përfaqësues të Bashkisë së Shkodrës, Vaut të Dejës dhe Malësisë së Madhe.

Ky event përmblyës me sukses zbatimin e projektit ndërkufitar i cili është zbatuar për 22 muaj në zonat ndërkufitare mes Shqipërisë dhe Malit të Zi. Përfaqësuesit përshëndetën rezultatet e arritura nga projekti, si dhe vlerësuan se nisma të tilla kontribuojnë drejtpërdrejt në politikat dhe vizionin e bashkive respektive.



AIDA informon rreth botimeve të reja

-Fletëpalosje Invest in Albania 2025

Fletëpalosja është ftesë nga AIDA për të lënë takimin tuaj në Agjenci për të bërë realitet planin tuaj për investim në vendin tonë.

Për më shumë informacion, fletëpalosjen e gjeni online në faqen tonë zyrtare www.aida.gov.al në rubrikën <Publikime>.

-Katalogu i plotë i botimeve - Invest in Albania

Katalogu - Invest in Albania pasqyron një përmbledhje të gjithë botimeve që AIDA ka krijuar për t'i ardhur në ndihmë investitorëve.

Përmbajtja e tij ofron akses në informacionin e përditësuar dhe lehtëson komunikimin efikas me individët, ndërmarrjet apo investitorët.

Katalogu ju jep mundësinë të skanoni QR Code që ju çon në botimin e plotë në web.

- ALBANIA CALLS: “A COUNTRY OF OPPORTUNITIES”;
- BRING YOUR BUSINESS TO ALBANIA;
- FACTSHEET RENEWABLE ENERGYSECTOR;
- FACTSHEET AGRICULTURE, AGRITOURISM AND AQUACULTURE SECTOR
- FACTSHEET MANUFACTURE SECTOR;
- FACTSHEET TOURISM SECTOR;
- FACTSHEET ICT AND BPO SECTOR;
- FACTSHEET TEDA;
- INVESTIMET STRATEGJIKE;



Platforma e Incentivave të Investimeve të Gjashtë Vendeve të Ballkanit Perëndimor WB6



Prezantohet, Platforma e Incentivave të Investimeve të Gjashtë Vendeve të Ballkanit Perëndimor. E para e këtij lloji në rajon, që ofron informacion të detajuar për secilin shtet nga WB6. Kjo është një nga masat kryesore në Zonën Rajonale të Investimeve, si pjesë e Planit të Veprimit të Tregut të Përbashkët Rajonal 2021-2024.

Bazuar nga të dhënat e Agjencive për Promovimin e Investimeve të rajonit, platforma përfshin incentiva financiarë dhe jo financiarë, të kategorizuara sipas llojit, sektorit dhe audiencës së synuar. Kjo platformë ofron informacion të plotë për investitorët që kërkojnë të investojnë në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor. Si një burim zhvillimi, platforma do të jetë e përditësuar çdo gjashtë muaj për të siguruar se do të përmbushë funksionin e saj.

AIDA ju fton të njiheni me publikimin më të fundit të publikuar nga Shoqata Gjermane e Outsourcing në kuadër të bashkëpunimit me GIZ

Industria ICT në Shqipëri po përjeton një zhvillim të shpejtë dhe po tërheq gjithnjë e më shumë vëmendje si një pikë strategjike për outsourcing dhe investime në teknologji, falë talentit vendas dhe kosto-efektivitetit konkurrues.

AIDA ju fton të njiheni me publikimin më të fundit të publikuar nga Shoqata Gjermane e Outsourcing në kuadër të bashkëpunimit me GIZ. "Outsourcing Destination Guide Albania" është një guidë e cila analizon kushtet dhe aktorët kryesorë të këtij sektori, duke përfshirë raste studimore dhe raportime projektsh nga ekspertë shqiptarë. Guida ndihmon vendimmarrësit të kuptojnë më mirë mundësitë për bashkëpunim me ofruesit e shërbimeve ICT apo investimin në qendra të reja operationale në Shqipëri

